



Pranuar / Doretuar Prilje / Prodato Received / Delivery	07-12-2022	2	viti god. year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHUK	7759/2022		1110



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.888/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Eshref Shabani kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari, dhe Jeton Koca, anëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr. 888/2022, të datës 11.10.2022, së ankuses me avokat me adrese banimi rruga nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Mbrojtjes, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.12.2022, mori:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër me numër A.nr. 888/2022, e datës 11.10.2022, së ankuses
- II. ANULOHET njoftimi i datës 27.09.2022 për anulimin e procedurës së Lëvizjes Brenda Kategorisë për pozitën "Zyrtar për Raporte dhe Analiza "
- III. MBETET në fuqi Raporti final i datës 05.08.2022 i Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë dhe njoftimi i datës 09.08.2022 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit.
- IV. REFUZOHET ankesa Anr.785/2022 e ankuses dhe ankesa Anr.786/2022 e ankuesit

V. **OBLIGOHET** Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Mbrojtës, që ta emërojë ankuesen me Akt Emërim në pozitën "Zyrtar për Raporte dhe Analiza" sipas legjislacionit në fuqi.

VI. **OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtës, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II dhe III të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

VII. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja sipas shkresave të lëndës kandidate për lëvizje brenda kategorisë në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes, me datë 11.10.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila ankesë është protokolluar me numër 6055/2022, me pretendimet ankimore kundër njoftimit të datës 27.09.2022 lidhur me anulimin e konkursit për pozitën "Zyrtar për Raporte dhe Analiza" duke obliguar organin kompetent që ankues ti lëshohet akt emërimi pasi që e njëjta është shpallur fituese në këtë konkurs.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Mbrojtjes. Ndërsa me datë 24.10.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.10.2022, me numër protokolli 6593/2022, ka nxjerr vendim me të cilin vendim ka bërë bashkimin e ankesave A. Nr. 785/2022, të datës 09.09.2022, të ankueses dhe ankesës A.nr. 786/2022 të datës 09.09.2022, të ankuesit si dhe ankesën A.nr. 888/2022, të datës 11.10.2022, së ankueses për shkak se objekti i ankesave ka qenë i njëjtë, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën " Zyrtar për Raporte dhe Analiza" të zhvilluar nga Ministria e Mbrojtjes.

Po ashtu me datë 23.11.2022, me numër protokolli 7353/2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerr vendim me të cilin ka shtyrë edhe dhjete (10) dhjete ditë, afatin e vendosjen lidhur me ankesën e ankueses për arsye të lëndës specifike.

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet edhe dy ankesave tjera të cilët janë bashkuar në ankesën Anr.888/2022, sipas ankuesëve të cilët pretendojnë se vlerësimi i tyre nuk ka qenë korrektë nga ana KVLB, ndërsa ankuesi ka pretendim edhe përbërjen e Komisionit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritorë, ka administruar këto prova: Ankesave A.nr. 888/2022 e të datës 11.10.2022, Anr.786/2022 dhe Anr.785/2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursi i datës 15.06.2022; e- maili i datës 15.08.2022; e- maili i datës 25.08.2022; Vendimi i datës 15.07.2022; Vendimi i datës 25.07.2022; e- maili i datës 09.08.2022; Njoftimi i datës 09.08.2022, për kandidatin e suksesshme; Njoftimi i datës 17.08.2022, për kandidatin e suksesshme; e- maili i datës 17.08.2022; Kërkesë e datës 26.09.2022; Autorizimi i datës 04.10.2022; Kërkesë e datës 06.06.2022; Vendimi i datës 21.07.2022, për Themelimin e Komisionit për Lëvizje brenda Kategorisë ;Lista e aplikanteve; Njoftimi i datës 15.07.2022, për Njoftimi i datës 15.07.2022, për Njoftimi i datës 15.07.2022, për Vendimi i datës 15.07.2022; Vendimi i datës 25.07.2022; E- maili i datës 03.08.2022; Njoftimi për intervistë; Formuari për vlerësimin e intervistës me gojë; për Formuari për vlerësimin e intervistës me gojë; për Formuari për vlerësimin e intervistës me gojë; për Formuari për vlerësimin e intervistës me gojë; për Formuari për vlerësimin e intervistës me gojë; për Formuari për vlerësimin e intervistës me gojë, për Formuari për vlerësimin e intervistës me gojë, për Formuari për vlerësimin e intervistës me gojë, për Formuari për vlerësimin e intervistës me gojë, për Raporti i datës 05.08.2022, nga Komisioni vlerësues; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura, Diplomë e datës 30.05.2001; Certifikatë e datës 03.03.2006; Diplomë e datës 12.08.2014; Certifikatë e datës 18-19, e muajit shkurt të vitit 2015; Certifikatë e datës 05-06, e muajit maj të vitit 2015; Vërtetim i datës 01.02.2002; Akt Emërimi i datës 27.07.2015; Akt Emërimi i datës 08.07.2013; Akt Emërimi i datës 01.07.2020; Vendimi i datës 12.05.2022; Vërtetim i datës 06.07.2022; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë; Dëshmi e datës 05.07.2022; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 20.12.2010; Certifikatë e datës 25.11.2019; Certifikatë e datës 15.08.2018; Certifikatë e datës 22-23, e muajit prill të vitit 2014; Vendimi i datës 09.04.2014; Lista e sigurisë; Vërtetimi i datës 15.02.2012; Akt Emërimi i datës 08.07.2013; Vërtetim i datës 06.06.2022; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimin i datës 11.06.2019; Vendimi i datës 11.06.2021, për transferimin e përkohshëm; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 27.03.2013; Diplomë e datës 09.10.2017; Marrëveshje për shërbime të veçanta; Vërtetim i datës 10.10.2016; Vërtetim i datës 17.05.2003; Certifikatë e datës 08.06.2018; Vërtetim i datës 06.07.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 22.03.2012; Certifikatë e datës 07-08, e muajit qershor të vitit 2021; Certifikatë e vitit 2014-2016; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; Vërtetim i datës 01.07.2022; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 23.09.2011; Diplomë e datës 26.01.2016; Vërtetim i datës 25.05.2017; Akt Emërimi i datës 12.12.2018; Akt emërimi i datës 12.12.2020; formuari për vlerësimin e rezultateve në punë, për vitin 2021; Vërtetim i datës 27.04.2022; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 08.03.2010; Diplomë e datës 26.05.2017; Vërtetim i datës 22.02.2022; formuari për vlerësimin e rezultateve në punë, për vitin 2021; Vërtetim për marrëdhënien e punës i datës 22.02.2022; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 24.03.2014; Diplomë e datës 21.40.2011;Diplomë e datës 19.02.2015; Vërtetim i datës 13.01.2015; Vërtetim i datës 01.09.2010; Certifikatë e vitit 2013; Vendim i datës 29.05.2014; dëshmi nga trusti për periudhën 26.06.2001, deri me datë

20.06.2017; formuari për vlerësimin e rezultateve në punë, për vitin 2021; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 24.02.2006; Diplomë e datës 14.09.2011; Certifikatë; vërtetim i datës 21.06.2022; formuari për vlerësimin e rezultateve në punë, për vitin 2021; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 08.06.2001; Certifikatat e vitit 2008; formuari për vlerësimin e rezultateve në punë, për vitin 2021; Vërtetim i datës 05.07.2022; Certifikatë e vitit 2010; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Vërtetim i datës 30.06.2022; diplomë e datës 25.04.2005; Certifikatë e muajit shtator të vitit 2019; Certifikatë e muajit shtator të vitit 2020; Certifikatë e muajit maj të vitit 2019; formuari për vlerësimin e rezultateve në punë, për vitin 2021; Konfirmimi i datës 30.06.2022; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Certifikatë e datës 23.04.2015; Certifikatë e datës 28.06.2013; Vërtetim i datës 03.06.2015; Vërtetim i datës 08.12.2014; Akt Emërimi i datës 30.01.2018; formuari për vlerësimin e rezultateve në punë, për vitin 2020-2021; Vërtetim i datës 31.05.2022; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Certifikatë e datës 30.07.2013; Certifikatë e datës 02-03, e muajit mars të vitit 2015; Certifikatë e datës 15-16, e muajit shkurt të vitit 2016; Certifikatë e datës 09-10, e muajit mars të vitit 2016; Akt Emërimi i datës 15.12.2015; ; Akt Emërimi i datës 01.12.2014; Vendim i datës 23.01.2020; Vendim i datës 29.09.2020; Formulari për vlerësim e rezultateve në punë, për vitin 2020-2021; Vërtetim i datës 05.07.2022; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 10.05.1984; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 01.07.2008; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimi i datës 20.01.2014; Formulari për vlerësim e rezultateve në punë, për vitin 2021; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 05.10.2008; Vendimi i datës 09.06.2009; Vendimi i datës 29.03.2013; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 01.09.2009; Akt emërimi i datës 05.07.2013; Vendim i datës 26.08.2019; Akt Emërimi i datës 05.07.2013; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 16.07.2012; Kontrata e punës e datës 02.09.2017; Vërtetim i datës 09.07.2018; Vërtetim i datës 11.12.2018; Vërtetim i datës 23.06.2022; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 25.07.2008; Vërtetim i datës 06.07.2022; Vërtetim i datës 14.08.2008; Kërkesë e datës 26.09.2022; Certifikatë e datës 22-23, e muajit mars të vitit 2022 Certifikatë e vitit 2018-2020; Certifikatë e vitit 2014-2016; Akt Emërimi i datës 01.02.2017; Rekomandim i datës 29.12.2021; Përgjigje në ankesë e datës 24.10.2022, me numër Protokolli 6427/2022. Ankesën me nr. protokolli 2196 të datës 12.08.2022 të parashtruar nga ankuesi për tek Komisioni i Vlerësimit; Vendimin me nr. protokolli 2216 të datës 16.08.2022 të lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes- Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë; Kërkesën për përgjigje në ankesë me nr. protokolli 5394/22 të datës 14.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë me nr. protokolli 5695/22 të datës 27.09.2022 nga Ministria e Mbrojtjes-Departamenti për Politikën e Personelit dhe Rekrutimit ;Njoftimin përfundimtar për kandidatin fitues të datës 17.08.2022 të lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes-Departamenti për Politikën e Personelit dhe Rekrutimit; Emailat zyrtar të datës 09.08.2022 nga Zyrtarja e Rekrutimit, Drejtorja e Burimeve Njerëzore,,vDepartamenti për Politika të Personelit dhe Rekrutimit në Ministrinë e Mbrojtjes; Njoftimin për kandidatin fitues të datës 09.08.2022; Listën e Distribuimit-Raportin e Komisionit vlerësues për pozitën Zyrtar për Raporte dhe Analiza me nr. protokolli

VK. Nr.129/2022 te datës 21.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankueses me nr. protokolli 5280/2022 të datës 09.09.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankueses drejtuar Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Ministrinë e Mbrojtjes me nr. protokolli 2197-2 të datës 12.08.2022; Vendim i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë me numër protokolli 2217-2 të datës 16.08.2022; Vendim për shtyrje të afatit për dhjetë 10 ditë pune nga Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 6377/2022 i datës 21.10.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.09.2022; Përgjigje në ankesë e datës 30.09.2022; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit i H.K. me nr. protokolli 2050-1 i datës 12.06.2019; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës e H.K. me numër 9 e datës 28.09.2008; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës e M.M. me numër 228 e datës 06.10.2008; Diplomë nga The Republic of Turkey mar Colleges Command e M.M. me nr. 54009 i datës 19.02.2015; Urdhër Gradim me numër protokolli 1438-01 i M.M. i datës 25.03.2022; Kontratë Pune e M.M. e datës 21.01.2012; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit i Q.TH. me nr. protokolli 1976-1 i datës 11.06.2019; Diplomë nga Kolegji AAB e Q.TH. me numër 482/17 i datës 15.06.2017; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës e Q.B. me numër 590 e datës 04.11.2005; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit e S.H. me nr. protokolli 2105-1 i datës 14.06.2019; Diplomë nga Kolegji Biznesi e S.H. me numër 079/11 i datës 24.02.2011; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit e I.XH. i datës 02.03.2020; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës e I.XH. me numër 1429 e datës 15.03.2011; Diplomë nga Kolegji Fama e I.XH. me numër 597/1018 i datës 12.10.2018; Diplomë nga Kolegji Biznesi me numër 106/11 i datës 27.07.2011; Aplikacioni i V.R.G. i datës 06.07.2022; Çertifikatë nga Universiteti i Prishtinës e V.R. me numër Ref.nr.20/579 e datës 30.07.2013; Çertifikatë nga IKAP për V.R.G. e datës 03.03.2015; Çertifikatë nga IKAP për V.R.G. e datës 16.02.2016; Çertifikatë nga IKAP për V.R.G. e datës 10.03.2016; Akt Emërim i V.R.G. me numër protokolli 6888-2 i datës 15.12.2015; Akt Emërim i V.R.G. me numër protokolli 7078-2 i datës 01.12.2014; Vendim me numër protokolli 437-1 i datës 23.01.2020; Vendim me numër protokolli 5668-1 i datës 29.09.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 e V.R.G. i datës 05.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 e V.R.G. i datës 08.01.2021; Vërtetim me nr. 4812 i datës 05.07.2022; Aplikacioni i A.B. i datës 07.07.2022; Dëshmi për masat disiplinore e A.B. i datës 05.07.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i A.B. i datës 19.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i A.B. i datës 27.01.2022; Vendim për transferimin e përkohshëm të brendshëm në interes të institucionit e A.B. me nr. protokolli 1184-2 i datës 12.05.2022; Akt Emërim i A.B. i datës 06.07.2020; Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme profesionale e A.B. e datës 30.05.2001; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës e A.B. e datës 28.01.2011; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës e A.B. e datës 01.07.2014; Diplomë nga Kolegji Pjetër Budi e A.B. me numër 35/2014 e datës 12.08.2014; Certifikatë e programit teoria infermierore dhe praktika klinike e A.B. e datës 03.03.2006; Certifikatë nga Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit, veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të UÇK-së e A.B. me numër protokolli 1/343 e datës 23.12.2015; Certifikatë trajnimi e A.B.; Certifikatë nga English Course e A.B. me numër 180/05 e datës 13.06.2005; Certifikatë nga TMK për A.B. e datës 02.09.2005; Certifikatë nga IKAP për A.B. i datës 19.02.2021; Certifikatë nga KeA për

A.B.; Dokument për pjesëmarrës nga kongresi II-të euroasiatik për shkencat mjekësore e A.B. e datës 29.09.2012; Certifikatë nga IKAP për A.B. i datës 02.04.2015; Certifikatë nga IKAP për A.B. i datës 06.05.2015; Certifikatë nga AUK për A.B. i datës 29.06.2016; Certifikatë nga i datës 18.05.2016; Certifikatë e A.B. me numër 1205/16 i datës 20.05.2015; Akt Emërim i A.B. me numër protokolli 3916-2 i datës 27.07.2015; Akt Emërim i A.B. me numër protokolli 2873-2 i datës 08.07.2013; Vërtetim nga TMK me numër protokolli 15/2147 i datës 09.06.2004; Vërtetim nga Ministria e Mbrojtjes e A.B. 06.06.2022; Vërtetim i A.B. me numër protokolli 01/0148 i datës 06.07.2022; Vërtetim nga SHSKUK për A.B. i datës 18.05.2015; Referencë nga AUV për A.B. i datës 22.06.2022; Referencë pune nga NTSH "Peshkopia" në Drenas për A.B. i datës 18.01.2012; Mirënjohje nga SHPQK për A.B. e muajit Dhjetor 2016; Mirënjohje nga TMK për A.B. e datës 10.12.2008; Njoftim përfundimtar për kandidatin fitues i datës 17.08.2022; E-mail nga J.B. për A.B. i datës 09.08.2022; E-mail nga J.B. për V.R.G. i datës 09.08.2022; Njoftim për kandidatin fitues i datës 09.08.2022; Raport i komisionit vlerësues për pozitën Zyrtar për Raporte dhe Analiza me nr. protokolli 2136-2 i datës 05.08.2022; Vlerësimet nga anëtarët e komisionit, Intervistës me gojë për pozitën Zyrtar për Raporte dhe Analiza Ministria e Mbrojtjes e V.R.G. 1/5 faqe; Vlerësimet nga anëtarët e komisionit, Intervistës me gojë për pozitën Zyrtar për Raporte dhe Analiza Ministria e Mbrojtjes e A.B. 1/5 faqe; Pyetjet për intervistë të kandidatëve për pozitën A3 Zyrtar për Raporte dhe Analiza; Orari për intervistim për pozitën Zyrtar për Raporte dhe Analiza i datës 05.08.2022; E-mail nga S.H. për A.B. etj. i datës 03.08.2022; E-mail nga S.H. për J.B. i datës 27.09.2022; E-mail nga S.H. për A.B. etj. i datës 01.08.2022; Lista e Aplikantëve nga SIMBNJ për pozitën Zyrtar për Raporte dhe Analiza; Vendim i datës 25.07.2022; Vendim i datës 15.07.2022; Njoftim për kandidatin SH.I. i datës 15.07.2022; Njoftim për kandidatin A.M. i datës 15.07.2022; Njoftim për kandidatin B.P. i datës 15.07.2022; Njoftim për kandidatin B.B. i datës 15.07.2022; Lista e Aplikantëve nga SIMBNJ për pozitën Zyrtar për Raporte dhe Analiza; Vendim me numër protokolli 1989-1 i datës 21.07.2022; Konkurs për Lëvizje Brenda Kategorisë i datës 15.06.2022; Kërkesë me numër protokolli 1488-2 i datës 06.06.2022

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e bazuar, SEPSE:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton së në konkursin e shpallur të datës 15.06.2022, për pozitën "Zyrtar për Raporte dhe Analiza", nga Ministria e Mbrojtjes, kriteret formale të konkursit kanë qenë:

- *Diplome Universitare, të studimeve Universitarë-në shkencat Politike/shkenca shoqërore, drejtësi menaxhimet apo fusha tjera, me të paktën 180, kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to.*
- *Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilin zhvillohet procedura për plotësim e pozitës së lirë të punës.*

Sa i përket shpalljes së konkursit Kolegji ka analizuar dispozitat e nenit 8 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës me theks të veçantë dispozitat lidhur me lëvizjen brenda kategorisë duke përfshirë edhe përbërjen e komisionit dhe në këto pika, Kolegji, ka

konstatuar se procedura e lëvizjes brenda kategorisë sipas konkursit të shpallur me datë 15.06.2022 për pozitën "Zyrtar për Raportime" Ministria e Mbrojtjes ka vepruar drejt dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kolegji ka shqyrtuar edhe pretendimet e dy ankuesve lidhur me mos vlerësimin e drejtë të tyre, por nga shkresat e lëndës nuk ka arritur të gjej ndonjë argument që të bind Kolegjin që të marr për bazë këto pretendime, prandaj si të tilla nuk kanë ndikuar që vendimmarrja të jetë ndryshe.

Kolegji i Këshillit është lëshuar në trajtim të pretendimeve të ankueses për arsye të anulimit të konkursit të lartpërmendur, dhe pas analizimit të gjitha shkresave të lëndës të bashkëngjitura nga palët në procedurë ka konstatuar se Ministria e Mbrojtjes ka shpallur konkursin me datë 15.06.2022 dhe ka respektuar dispozitat e shpalljes së konkursit, gjithashtu pas shpalljes së konkursit sipas shkresave të lëndës ka bërë respektimin e të gjitha fazave të konkursit të paraparë tek dispozitat për lëvizje brenda kategorisë. Pas përmbylljes së intervistës me gojë, sipas shkresave të lëndës dy kandidatë kanë parashtruar ankesë kundër njoftimit të përzgjedhjes së kandidatit, gjegjësisht ankesa është parashtruar nga ankuesja me datë: 12.08.2022 në KVLB, Ministria e Mbrojtjes ankueses ju ka përgjigjur me datë: 16.08.2022 përmes vendimit 2217/2 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses duke i dhënë këshill të qartë juridike se pala e pa kënaqur mund të parashtrojë ankesë në KPMSHCK, gjithashtu ankuesi ka parashtruar ankesë në KVLB me datë: 12.08.2022, ndërsa MM i është përgjigjur me datë 16.08.2022 me vendimin Nr.2216/2 me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit duke i dhënë këshill juridike të qartë.

Pas përmbylljes së këtyre Ministria e Mbrojtjes, ka bërë një njoftim me të cilën ka njoftuar të gjithë kandidatë për rezultatin përfundimtar duke ju dhënë këshill juridike për KPMSHCK, gjë të cilën Kolegji e konsideron në frymë të dispozitave ligjore.

Pas përfundimit të gjithë procedurës së lëvizjes brenda kategorisë për pozitën e lartshënuar, me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm dhe me miratim të Ministrit të Mbrojtjes më datë 25.08.2022 Auditori i Brendshëm i Ministrisë së Mbrojtjes ka bërë një auditim të konkurseve në Ministrinë e Mbrojtjes lidhur me lëvizjen brenda kategorisë dhe sipas raportit të ZAB të MM në faqen 5 të raportit tek përmbledhja ekzekutive adutori i brendshëm i konstaton dy mangësi që kanë hasur citoj "Mos kuptimi i drejtë i kushteve të konkursit tek kërkesat e përgjithshme formale- tek përvoja e punës 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, nga DBNJ ka ndikuar në verifikimin paraprak të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar kriterin për pozitën për të cilën kanë aplikuar dhe jo në harmoni sipas nenit 45 të Rregullores QRK 16/2020" mbyllet citati. Gjithashtu në faqen 6 të këtij raporti ku Auditori i Brendshëm listën "Është vërejtur për të mire" se pika 2. Citoj " konkurset brenda kategorisë janë bërë në harmoni me legjislacion"

Kolegji i ka analizuar vetëm këto dy citate të lartshënuar në raport dhe ka konstatuar se Auditori i Brendshëm në Ministrinë e Mbrojtjes në këtë raport bie në kundërtënie të hapur me atë që e shkruan vetë, prandaj Kolegji pas analizimit të gjitha shkresave të lëndës të bashkëngjitura nga palët në procedura ka konstatuar se procedura për pozitën "Zyrtar për

Raportime dhe Analiza" në Ministrinë e Mbrojtjes është bërë konform dispozitave ligjore në fuqi.

Me datë 27.09.2022, Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Departamenti për Politika ka njoftuar kandidaten e pazgjidhur se në bazë të rekomandimeve të Auditorit të Brendshëm dhe kërkesës së Zv. Sekretarit të Përgjithshëm për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Brendshëm, anulohet konkursi i datës 05.06.2022 për pozitën "Zyrtar për Raportime dhe Analiza" më nr ref. RN00009195.

Kolegji duke marrë për bazë se anulimi i konkursit për pozitën e lartshënuar është bërë duke u bazuar në raportin e Aduditorit të Brendshëm, duke mos përfillur afatin për parashtrim të ankesave në KPMSHC, si dhe duke mos pritur vendimmarrjen nga ky organ, ka konstatuar se Ministria e Mbrojtës ka vepruar në kundërshtim me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "*...3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative", sepse e të drejtë ekskluzive në procedurën administrative për vendimmarrje lidhur me marrëdhënien e punës në shërbimin civil të Kosovës, sipas ankesave të ankuesve është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e drejtë e cila buron nga neni 101 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku përcaktohet se "*Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës*".*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka pranuar ankesat e ankueseve, për procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Raportime dhe Analiza", në Ministria e Mbrojtjes, dhe bashkimit të ankesave të ankueseve për arsye se objekti i ankesave ka qenë i njëjtë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas administrimi të provave vërtetimit të fakteve dhe vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, konstaton se procedura e lëvizjes brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për Raportime dhe Analiza" është zhvilluar në pajtim me nenin 38 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht lista e verifikimit paraprak është bërë në pajtim me nenin 44 dhe 45 të kësaj rregulloreje dhe janë vlerësuar në mënyrë të drejtë aplikacionet e kandidatëve sa i përket arsimimit të kërkuar dhe përvojës së punës, po ashtu në bazë të provave të administruara, Kolegji i Këshillit, konstaton se vlerësimi i kandidateve është bërë në pajtim të plotë me nenin 47 të Rregullores (QRK) nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa edhe rezultati përfundimtar është në pajtim me nenin 48 dhe 49 të kësaj rregulloreje

Kolegji i Këshillit, pas konstatimeve si më lartë, vlerëson se Ministria e Mbrojtës, nga fillimi i procedurës së rekrutimit deri të njoftimi për kandidatin e suksesshëm, ka vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "**1. Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës**

dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive”.

Nisur nga këto, Kolegji konstaton se njoftimi për anulimin e kësaj procedurë mbi bazën e raportit të Auditorit të Brendshëm është në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe është në kundërshtim me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/1-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj edhe pretendimet e ankueses janë të bazuara.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se, organi i punësimi Ministria e Mbrojtës, është e obliguar që pas pranimi të këtij vendimi, të ndërmarë të gjitha veprimet sipas diapozitivit të këtij vendimi dhe të veprojë në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.888/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokatit
- Ankuesve
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.